

## Politika e Cookies

### PARA SE TË FILLOSH...

Në këtë Politikë të Cookies do të gjesht informacione lidhur me mënyrën se si i përdorim *cookies* dhe skedarë të ngjashëm që instalohen në терминаlet e klientëve dhe përdoruesve tanë. Ndonjëherë, përdorimi i *cookies* mund të lidhet me përpunimin e të dhënave personale. Për këtë arsye, nëse të duhet informacion për mënyrën se si i përdorim të dhënat personale të klientëve dhe të përdoruesve tanë, për mënyrën se si mund të ushtrosh të drejtat e tua ose për terminologjinë që përdorim për t'iu referuar platformës sonë (ueb, aplikacion ose dyqane fizike), të rekomandojmë të lexosh Politikën e Privatësisë, të disponueshme në platformën tonë.

### INFORMACIONE PËR COOKIES

#### 1. Cfarë është një Cookie?

Cookie është një skedar i vogël teksti që një faqe uebi, aplikacion apo platformë tjetër e ruan në kompjuterin, tabletën, telefonin inteligjent ose çdo pajisje tjetër që ti përdor, i cili përmban informacione rreth shfletimit ose përdorimit të faqeve të internetit, si një etiketë identifikuese e pajisjes sate. Cookies janë të nevojshme, për shembull, për të lehtësuar shfletimin në internet dhe për të kuptuar se si ndërveprojnë përdoruesit me platformat, me qëllim përmirësimin e këtij procesi. Ato janë gjithashtu shumë të rëndësishme për të mundësuar ofrimin e reklamave në bazë të preferencave të përdoruesit, si dhe për qëllime të tjera që do të shtjellohen në vijim. Cookies nuk e dëmtojnë kompjuterin apo pajisjen tënde.

Kur flasim për "Cookies", i referohemi gjithashtu edhe teknologjive të tjera të ngjashme për instalimin dhe/ose mbledhjen e informacioneve në pajisjen tënde ose rreth saj [si *flash cookies*, *web beacons* (sinjalizues uebi) apo *bugs* (defekte në kod), *pixels* (pikselë), HTML5 (për ruajtjen në njësinë lokale)] dhe teknologjitë SDK për formatet e aplikacioneve. Termi "Cookies" i referohet gjithashtu edhe përdorimit të teknikave të tilla si *fingerprinting* (shenjat e gishtërinjve), pra atyre teknikave të kombinimit të informacionit që na ndihmon të identifikojmë pajisjen tënde. Në disa raste, këto teknologji bashkëveprojnë me *cookies* për të mbledhur dhe për të ruajtur informacionin, për të të mundësuar disa funksione ose shërbime të caktuara në platformën tonë, si dhe për të të shfaqur reklama në platformat e palëve të treta, bazuar në shfletimin tënd në internet.

Shpjegimi i mësipërm është një shembull i përgjithshëm i asaj që nënkuptojnë Cookies për qëllime informimi. Cookies që përdorim në mënyrë specifike detajohen në panelin e konfigurimit të cookies, e cila disponohet në platformën tonë.

#### 2. Cilat janë llojet ekzistuese të Cookies?

Të ftojme të lexosh këtë seksion që ofron një vështrim të përgjithshëm lidhur me llojet e Cookies që mund të përdoren në një mjedis online.

Në bazë të zotëruesit të Cookies, ato mund të klasifikohen në:

- a. Cookies vetjake: Janë ato Cookies që dërgohen në kompjuterin ose pajisjen e përdoruesit nga një pajisje apo domen i menaxhuar nga vetë publikuesi, dhe nga i cili ofrohet platforma apo shërbimi i kërkuar nga përdoruesi.
- b. Cookies nga palë të treta: Janë ato Cookies që dërgohen në kompjuterin ose pajisjen e përdoruesit nga një pajisje apo domen që nuk menaxhohet nga vetë publikuesi, por nga një entitet tjetër që përpunon të dhënat e mbledhura nga cookies.

Në bazë të qëllimeve të Cookies, ato mund të klasifikohen në:

- a. Cookies absolutisht të nevojshme (teknike): Janë ato Cookies që i mundësojnë përdoruesit të shfletojë një faqe interneti, platformë ose aplikacion dhe të përdorë opsionet apo shërbimet e ndryshme që përmbajnë ato, si për shembull, kontrollin e trafikut, identifikimin e të dhënave apo të sesionit, hyrjen në seksionet apo përmbajtjet me qasje të kufizuar, memorizimin e elementeve që përbëjnë një porosi, realizimin e procesit të blerjes së një porosie, menaxhimin e pagesës, kontrollin e mashtrimeve që lidhen me sigurinë e shërbimit, përdorimin e elementeve të sigurisë gjatë shfletimit në internet, realizimin e kërkesës për regjistrim apo pjesëmarrje në një ngjarje, regjistrimin e përmbajtjeve për ndarjen e videove apo tingujve, aktivizimin e përmbajtjeve dinamike (për shembull, animimin e ngarkimit të një teksti apo imazhi) ose ndarjen e përmbajtjeve në rrjetet sociale. Cookies teknike, të cilat janë absolutisht të nevojshme, shkarkohen automatikisht kur lejohet shfaqja e platformës ose ofrimi i shërbimit të kërkuar nga përdoruesi.
- b. Cookies funksionale apo personalizimi: Këto Cookies i mundësojnë përdoruesit memorizimin e informacionit për të hyrë në shërbim apo në platformë me karakteristika të caktuara që mund ta ndryshojnë përvojën e tyre nga ajo e përdoruesve të tjerë, si për shembull, gjuha, numri i rezultateve që do të shfaqen kur përdoruesi bën një kërkim, pamja ose përmbajtja e shërbimit në funksion të llojit të shfletuesit të përdoruesit ose të rajonit nga i cili përdoret shërbimi etj. Mospranimi i këtyre Cookies mund të sjellë performancë të ngadaltë të faqes së internetit ose rekomandime të papërshtatura si duhet.
- c. Cookies analitike: Janë ato Cookies që mundësojnë përlogaritjen e numrit të përdoruesve, seksionet e vizituara në platformë dhe mënyrën e ndërveprimit me të, për të bërë matjen dhe analizën statistikore të përdorimit nga ana e përdoruesve, me qëllim përmirësime të ndryshme në funksion të të dhënave të përdorimit nga ana e përdoruesve të platformës apo të shërbimit.
- d. Cookies të reklamimit sipas sjelljes: Janë ato Cookies që ruajnë informacionin e sjelljes së përdoruesve, të përftuar nga vrojtimi i vazhdueshëm i zakoneve të tyre të shfletimit në internet, gjë që mundëson krijimin e një profili specifik për të shfaqur reklama në funksion të vetë këtij profili. Këto Cookies mundësojnë menaxhimin në mënyrën më efikase të mundshme të hapësirave reklamuese, që në rastin e tyre, publikuesi i ka përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bashkëpunim me palë të treta.

### **3. Për çfarë përdoren Cookies në platformën tonë?**

Cookies janë një pjesë thelbësore e funksionimit të platformës sonë. Objektivi kryesor i Cookies që përdorim është të të ofrojmë një përvojë më komode dhe efikase gjatë shfletimit në internet. Për shembull, ato përdoren për të memorizuar preferencat e tua (gjuha, vendi etj.) gjatë shfletimit të faqeve të internetit dhe kur i viziton ato sërish. Cookies i përdorim gjithashtu për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe të platformës sonë, si dhe për të mundësuar ofrimin e reklamave të personalizuar sipas zakoneve të tua të shfletimit në internet.

Informacioni i mbledhur në Cookies na mundëson, veç të tjerash, të përmirësojmë platformën tonë duke bërë parashikime rreth të dhënave statistikore dhe modeleve të përdorimit (numri i vizitave, seksionet më të vizituara, kohëzgjatja e vizitës etj.), të kuptojmë në mënyrë statistikore se si ndërveprojnë përdoruesit me platformën, me qëllim përmirësimin e shërbimeve tona, si dhe ta përshtatim platformën sipas interesave të tua individuale, të përshpejtojmë kërkimet etj.

Ka raste kur mund t'i përdorim Cookies për të marrë informacione që na mundësojnë të shfaqim platforma të palëve të treta nga platforma jonë, ose në mënyra të tjera, reklama të bazuara në analizën e zakoneve të tua të shfletimit në internet (produktet e vizituara, seksionet ku ke hyrë etj.).

Në çdo rast, në Cookies që përdorim, nuk ruajmë asnjëherë informacione delikate si fjalëkalimet, të dhëna të kartave të kreditit apo të debitit etj.

#### **4. Si mund ta menaxhoj përdorimin e Cookies në këtë platformë?**

Në panelin e konfigurimit të Cookies, i cili disponohet në çdo moment në platformën tonë, mund të marrësh të gjitha informacionet lidhur me Cookies të përdorura nga kjo platformë, së bashku me informacionet që lidhen me qëllimin, kohëzgjatjen dhe menaxhimin (nga ana jote apo nga palë të treta) të secilës prej tyre, për të menaxhuar aktivizimin dhe çaktivizimin e përdorimit të atyre Cookies që nuk janë absolutisht të nevojshme për funksionimin e platformës.

Kur i çaktivizoni kukit, sa herë është e mundur, kukit e ndikuar fshihen nga shfletuesi juaj dhe, në çdo rast, kur refuzoni një kuki por nuk është e mundur ta fshini atë, bllokojeni gjithmonë. Prandaj, ne nuk do të përdorim asnjëherë kuki që i refuzoni dhe do të bëjmë më të mirën për t'i fshirë ato (vini re se disa mekanizma të fshirjes janë jashtë kontrollit tonë, pasi varen nga palë të treta që janë përgjegjëse për kukin).

Përndryshe, gjatë kohës që shfleton në internet, mund ta çaktivizosh përdorimin e Cookies në shfletuesin tënd. Më poshtë po paraqesim se si bëhet kjo në shfletuesit më të përdorur:

- [Google Chrome](#)
- [Internet Explorer](#)
- [Mozilla Firefox](#)
- [Safari](#)

Shmangia e përdorimit të Cookies mund të ndërpritet në çdo moment.

Ki parasysh që menaxhimi i panelit të konfigurimit të Cookies, ashtu edhe opsioni i refuzimit të Cookies, është specifik për çdo shfletues që përdor. Për më tepër, nëse zgjedh t'i konfigurosh Cookies në një mënyrë të caktuar në një pajisje dhe dëshiron që të aplikohet i njëjti opsion edhe në një pajisje tjetër, duhet të aktivizosh po atë opsion edhe për pajisjen tjetër.

Për sa i përket Cookies të palëve të treta që synojnë ofrimin e reklamave të bazuara në interesat e tua, ki parasysh se disa palë të treta mund të jenë anëtarë të disa prej programeve vetërregulluese të reklamave sipas sjelljes online, me opsionet përkatëse të përjashtimit vullnetar:

- Network Advertising Initiative (NAI) - <http://www.networkadvertising.org/choices/>
- Google Analytics - <https://tools.google.com/dlpage/gaoptout>

#### **5. Kush i përdor informacionet e ruajtura në Cookies?**

Informacionet e ruajtura në Cookies të platformës sonë përdoren vetëm nga ne, me përjashtim të atyre që specifikohen në paragrafin 2 si "Cookies të palëve të treta", të cilat përdoren dhe menaxhohen nga entitete të jashtme për të na mundësuar ofrimin e shërbimeve që synojnë përmirësimin e shërbimeve tona dhe të përvojës së përdoruesit gjatë shfletimit në platformën tonë. Për më shumë informacion, hyr në panelin e konfigurimit të Cookies, të disponueshëm në çdo moment në platformën tonë.

Për të marrë informacione më të detajuara lidhur me përpunimin e të dhënave të tua personale në bashkëpunimin tonë me palë të treta dhe me ato që janë subjekt i transferimit ndërkombëtar të të dhënave, të sugjerojmë të lexosh Politikën tonë të Privatësisë, të disponueshme në platformën tonë, si dhe politikat e privatësisë/konfigurimet e privatësisë të këtyre palëve të treta, të cilat disponohen në platformat e tyre.

